



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

SYLLABUS i lëndës MENAXHIMI I OPERACIONEVE

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	FAKULTETI I BIZNESIT
Titulli i lëndës:	Menaxhimi i operacioneve
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	II (semestri III)
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	FB
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	Në këtë lëndë trajtohet problematika e menaxhmentit të operacioneve, si pjesë thelbësore e menaxhmentit të tërësishëm të ndërmarrjes. Operacionet janë përgjegjëse për menaxhim efikas të këtyre detyrave dhe për të t'i gjetur mënyrat për përmirësime, për t'i përmbushur më mirë objektivat e biznesit dhe nevojat e konsumatorëve.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i lëndës është që në kuadër të tërësisë së menaxhimit të ndërmarrjes të studiohet menaxhimi i operacioneve, funksioni i të cilave është transformimi i inputeve në outpute, përkatësisht në shërbime dhe produkte. Qëllimi themelor i lëndës është që të arrihet menaxhimi efikas i këtij funksioni, përkatësisht i përmbushjes së objektivave të biznesit dhe nevojave të konsumatorëve. Qëllim tjetër i lëndës është poashtu edhe menaxhimi i personelit (njerëzve), ashtu që të përmbushen afatet e kontraktuara kohore, nivelet e produktivitetit dhe synimet tjera të biznesit, duke bërë njëkohësisht zgjerimin e shkathtësive bazike të personelit.

Rezultatet e pritura të nxënies:	Nëpërmjet kësaj lënde pritet që studentët të fitojnë njohuri të duhura nga teoria dhe praktika e sferave vijuese të operacioneve: - projektimi i shërbimeve, - projektimi i produkteve, - projektimi i sistemeve të dërgesës, - menaxhimi i sistemit të operacioneve - kontrolli i sistemit të operacioneve, - avancimi i operacioneve.

ECTS Kredi			
Aktiviteti i studentit (korrespondon me pritjet e studentit për lëndën mësimore)	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	2	2
Detyra shtëpie	1	5	5
Seminare, projekte, prezentimet,etj.	1	3	3
Koha e studimit vetanëk të studentit	1	15	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	5	5
Përgaditja përfundimtare për provim	5	4	20
Vërejtje: 1 ECTS kredi = 25 orë angazhim, p.sh. nëse lënda i ka 5 ECTS kredi studenti duhet të ketë angazhim gjatë semestrit 125 orë		Ngarkesa totale:	125

Metodologjia e mësimdhënies:	Metodologjia e zhvillimit të lëndës konsiston në tri orë ligjerata dhe dy orë ushtrime. Ligjeratat kryesisht shtjellojnë aspekte teorike të menaxhimit të operacioneve, kurse në kuadër të punës praktike do të analizohen aspekte praktike të operacioneve, duke përfshirë edhe studimet përkatëse të rastit. Në mënyrë që studentët të jenë gjithnjë në rrjedha me lëndën e shtjelluar dhe që të sigurohet kalueshmëri e suksesshme nga lënda, brenda semestrit organizohet testimi i studentëve dhe hartimi i një seminari gjithëpërfshirës.

Metodat e vlerësimit:	Kolokiumi i parë- 40% Kolokiumi i dytë- 40% Punimi seminarik- 10% Vijueshmëria dhe ineteraktiviteti në klasë- 10%
Literatura	
Literatura bazë:	1. Menaxhimi i operacioneve, Koncepte, Metoda, Strategji, Prof. Dr. Suzana Panariti, Tiranë, 2008. 2. Menaxhimi i operacioneve, Problema dhe raste studimi, Suzana Panariti & Arbina Rexhaj & Arjan Qefalia, Tiranë, 2009.
Literatura shtesë:	1. Operation Management, Jay Heizer (Texas Lutheran University), & Barry Render (Graduate School of Business, Rollins College), Prentice Hall, 2010. 2. Operation Management, Creating Value along the supply chain, Bernard W. Taylor & Roberta S. Russell, 2010.
Plani i dizejnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Hyrje në Menaxhimin e operacioneve
Java e dytë:	Strategjia e operacioneve & Prioritetet konkurruese
Java e tretë:	Projektimi dhe zhvillimi i shërbimeve dhe produkteve
Java e katërt:	Projektimi i procesit të prodhimit dhe shërbimit; Parashikimi i kërkesës
Java e pestë:	Menaxhimi i kapaciteteve
Java e gjashtë:	Projektimi i sistemit të punës, Sitemimi i procesit
Java e shtatë:	Testi i parë
Java e tetë:	Planifikimi kohor dhe realizimi i operacioneve
Java e nëntë:	Menaxhimi i cilësisë
Java e dhjetë:	Menaxhimi total i cilësisë
Java e njëmbëdhjetë:	Menaxhimi i zinxhirit furnizues
Java e dymbëdhjetë:	Menaxhimi i rezervave

Java e trembëdhjetë:	Planifikimi dhe kontrolli i projektit
Java e katërbëdhjetë:	Planifikimi i burimeve
Java e pesëmbëdhjetë:	Testi i dytë

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
Studentët janë të obliguar të përcjellin me rregull ligjëratat dhe ushtrimet. Ata duhet të vijnë me kohë në mësim, të jenë të disiplinuar dhe të jenë aktiv gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve. Studentët duhet t'i përmbushin në tërësi detyrat të cilat iu parshtrohen në kuadër të lëndës.